



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2023:238477

Datë: 15.01.2024

Numri i dokumentit: 05191379

PPP.nr.590/2023

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Përparim Zeka, në çështjen përbarimore të kreditorit të përbarimit: Kompania Rajonale Ujësjellësi “Prishtina”, sh.a. në Prishtinë, ndaj debitorit të përbarimit: A.A. nga P..., për pagesën e borxhit, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të përbarimit të ushtruar kundër urdhërit mbi caktimin e përbarimit P.nr.... të datës 25.09.2023 të përbaruesit privat I.Sh. si organ përbarues, jashtë seance me datë 12.01.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht si i bazuar, prapësimi i debitorit të përbarimit: A.A. nga P..., dhe shfuqizohet urdhëri mbi caktimin e përbarimit P.nr.... të datës 25.09.2023, të përbaruesit privat I.Sh. si organ përbarues, për shumën prej 109.67€ të kërkesës objekt i përbarimit.

II. Refuzohet si i pabazuar, prapësimi i debitorit të përbarimit: A.A. nga P..., sa i përket kërkesës objekt i përbarimit në shumën prej 491.08€, dhe për këtë shumë urdhëri mbi caktimin e përbarimit P.nr.... të datës 25.09.2023, mbetet në fuqi.

A r s y e t i m

Përmbareuesi privat I.Sh. si organ përmbareues, me Urdhërin P.nr.... të datës 25.09.2023, e ka caktuar përmbareimin në këtë çështje përmbareimore në bazë të dokumentit të besueshëm-Ekstrakti nga librat e kontabilitetit, shifër ..., pas vlerësimit se dokumenti i besueshëm përbën bazën juridike dhe paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21, 29 pika 1.2, i përshtatshëm për përmbareim sipas nenit 29 par.3 të Ligjit për Procedurën Përmbareimore Nr.04/L-139 të Republikës së Kosovës.

Kundër urdhërit të përmbareuesit privat mbi caktimin e përmbareimit P.nr.... të datës 25.09.2023, në afat të rregullt ligjor ka ushtruar prapësim debitori i përmbareimit me arsyetimin se, borxhi i pretenduar për këtë pjesë është parashkruar në bazë të nenit 360 par.1 të LMD-së, dhe kreditori nuk mund të kërkojë nga debitori përmbushjen e tij. Tutje ka shtuar se dokumenti në bazë të cilit është lëshuar urdhëri përmbareimor, nuk është i përshtatshëm për përmbareim sepse nuk i përmbush kriteret e përcaktuara në kuptim të nenit 29 të LPP-së, e po ashtu nga analizimi i përmbajtjes së të njëjtit ekzistojnë paqartësi të cilat janë me ndikim që të mos dihet saktësisht se cili është borxhi i saktë. Po ashtu ka shtuar se, nga analizimi i ekstraktit mbi bazën e të cilit është lëshuar urdhëri përmbareimor, i cili përfshin periudhën kohore në mes të datës 01.01.2013 e deri me datë 31.08.2023, atëherë nuk mund të kuptohet saktësisht se cila është shuma e borxhit që debitori i detyrohet kreditorit, për shkak se nga kalkulimi i shumës së faturave totale për këtë periudhë, dhe pagesave të kryera nga kreditori gjatë kësaj periudhe ekzistojnë mospërputhje evidente të cilat mund të sqarohen vetëm përmes ekspertizës financiare, e që një gjë e tillë e cila mund të zgjidhet vetëm në procedurë kontestimore dhe assesi në procedurë përmbareimore.

Prandaj i ka propozuar gjykatës që ta shfuqizoj urdhërin për përmbareim P.nr.... të datës 25.09.2023.

Kreditori i përmbareimit në afat të rregullt ka paraqitur përgjigje në prapësimin me të cilën i ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit duke theksuar se prapësimi është i pabazuar, pa argumentuar, si dhe pa mbështetje në prova. Kreditori i kundërshton deklaratimet e debitorit lidhur me parashkrimin pasi që debitori ka pranuar borxhin e tij dhe njëkohësisht ka bërë pagesa të pjesshme, duke u bazuar edhe në LMD-në përkatësisht në nenin 368, ku thuhet se parashkrimi ndërprehet kur debitori e pranon

borxhin, dhe pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën kreditorit, por edhe në mënyrë të tërthortë sikurse janë pagesa e pjeshme.

Po ashtu debitori e ka ndërprerë parashkrimin me pagesat e bëra kundrejt kreditorit dhe atë me datë 15.11.2022 në vlerën prej 50.00€, me datë 13.09.2022 në vlerën prej 50.00€, me datë 12.07.2022 në vlerën 50.00€, me datë 14.06.2022 në vlerën 50.00€, me datë 10.05.2022 në vlerën 30.00€, me datë 07.02.2022 në vlerën 80.00€, me datë 27.10.2021 në vlerën 200.00€, me datë 08.06.2022 në vlerën 80.00€, me datë 17.05.2021 në vlerën 80.00€, me datë 02.04.2021 në vlerën 80.00€, me datë 09.03.2021 në vlerën 80.00€, andaj debitori vazhdimisht e ka pohuar borxhin me pagesat e bëra ndaj kreditorit.

Prandaj, ka kërkuar nga gjykata që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe të paargumentuar, dhe njëkohësisht të obligoj debitorin që të kryej obligimin ndaj kreditorit.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësim të debitorit të përmbartimit dhe analizimit të shkresave të lëndës, ka gjetur se prapësimi i debitorit të përmbartimit duhet të aprovohet pjesërisht si i bazuar dhe ka vendosur si në pikën një të dispozitivit, pas konstatimit se në këtë pjesë borxhi i kërkuar të realizohet me detyrim është parashkruar, për faktin se kreditori i përmbartimit propozimin për përmbartim e ka paraqitur me datë 22.09.2023, ndërsa sipas nenit 360.1 të LMD-së është rregulluar se: “kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake” parashkruhen pas kalimit të një viti, ndërsa, sipas paragrafit 2 të njëjtit neni është rregulluar se: “afati i parashkrimit rrjedh nga fundi i vitit në të cilin arrin kërkesa për pagesë”. Sipas par.2 të LMD-së, rrjedhimisht kreditori e ka humbur të drejtën për të kërkuar realizimin me detyrim të kërkesës së arritur për pagesë para datë 31.12.2021 në shumën prej 109.67€, dhe se i njëjti nuk ka afuara asnjë provë- dokument që do të ndikonte që gjykata të vendos ndryshe nga ajo që ka vendosur në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Kjo edhe sipas praktikës gjyqësore të Gjykatës Supreme të Kosovës të krijuar me aktgjykimin Rev.nr.148/2012 të dt:09.09.2013, me të cilin është sqaruar situata se: “borxhi për shpenzimin e energjisë elektrike është borxh periodik meqë i njëjti arrinë

pas përfundimit të çdo muaji, dhe afati 1 vjeçar i paraparë në nenin 378 npar.1 pika 1 të LMD për parashkrim rrjedh për secilin muaj pas momentit të përfundimit të atij muaji, që do të thotë se parashkrimi llogaritet për secilin muaj në mënyrë të veçantë.

Si në pikën dy të dispozitivit, gjykata vendosi pasi pretendimet në prapësim të debitorit të përmbarimit, i ka vlerësuar si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se nuk ka ofruar asnjë provë në mbështetje të pretendimeve të tij siç është paraparë me nenin 69 par. 4 të LPP-së, rrjedhimisht nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet ligjore për anulimin e urdhërit mbi caktimin e përmbarimit, apo shtyrjen e zbatimit të përmbarimit, të përcaktuara me dispozitat e nenit 61 par 1 pika 1 dhe nenit 71 par 1, pika 1 deri në 12 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (Ligji nr. 04/L-139), të Republikës së Kosovës.

Nga arsyet e paraqitura, e në bazë të nenit 73 të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm

PPP.nr.590/2023, datës 12.01.2024

Gjyqtari

Përparim Zeka

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi lejohet ankesa në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit në dorëzim, përmes kësaj gjykate për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë